

## Tre pike dhe PIKE

nga Gent Mebelli

E premte, 26 Mars 2021 02:31

---

ANDORRA: Gomes | Llovera, Vales, San Nikolas, Rubio | Martinez, Rebes, Vieira, Cervos | Alaez, Fernandez.



Trajner: Koldo Alvarez

SHQIPËRI: Berisha | Gjimeshiti, Kumbulla, Ismalji, Lenjani, Hysaj | Gjasula, Bare, Memushaj | Cikalleshi, Manaj.

Trajner: Edi Reja

Shqiperia e nis me kembe e mbare rrugen per ne Boterorin "Katar 2022", duke mposhtur Andorren me rezultatin 1-0.

Ne minuten e 41' te ndeshjes, mbas nje kombinimi te bukur me Baren, mesfushori i krahut te majte Ermir Lenjani mposht portierin Gomes duke gjuajtur forte me majten.

## **Tre pike dhe PIKE**

nga Gent Mebelli  
E premte, 26 Mars 2021 02:31

---

Ashtu si deklaroi ne konferencen e shtypit nje dite perpara sfides kunder Andores, Edi Reja nuk beri eksperimente. Me skemen 3-5-2, ai i besoi lojtareve qe i dhuruan vendin e pare ne grupin e katert te Liges C ne kompeticionin " UEFA Nations League 2020/21".

Duke pasur vetem nje dite kohe per te pergatitur ndeshjen me Andoren, nuk mund te prisnim mrekullira.

Ne pjesen e pare te ndeshjes ekipi beri nje loje te mire me kombinime dhe aksione te bukura ne fazen sulmuese.

Ne pjesen e dyte vuajti presingun e Andorres duke humbur saktesine ne pasime, fantazine ne mesfushe dhe qetesine ne sulm.

Me nje fitore minimale Kombetarja Shqiptare ben detyren dhe merr:

**Tre pike dhe PIKE !**

**Forca SHQIPERI**

Gent Mebelli